

LIGJ
Nr. 8360, datë 10.6.1998

**PËR KRITERET DHE MËNYRËN E SHPËRNDARIES SË PASURISË SË PERSONAVE
JURIDIKË JOBANKARË QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË**

Nisur nga qëllimi i mbrojtjes sa më të mirë të interesave të kreditorëve, në zbatim të programit të qeverisë dhe në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", nenit 10 të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

1. Ky ligj rregullon mënyrën e shpërndarjes së vlerave financiare të shoqërive tregtare, subjekte të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë".

2. Mënyra e vënies në shitje të pasurive të shoqërive të mësipërme bëhet me ligj të veçantë.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji:

a) "Shoqëria huamarrëse" është shoqëria tregtare subjekt i ligjit nr.8227, datë 30.7.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë që kanë marrë hua nga publiku i gjerë".

b) Kreditor është personi fizik ose juridik, i cili ka depozituar të holla tek shoqëria huamarrëse ose ndaj të cilit kjo shoqëri ka detyrime.

c) "Aset" është çdo pronë e shoqërive ose e personave të lidhur me to.

ç) "Shumë detyrimi" është kapitali i depozituar minus tërheqiet në trajtë interesi kapitali ose çdo formë tjetër përfitimi nga kreditori.

d) "Rikapitalizim" është çdo ridepozitim i interesave të depozituara përsëri në çastin e tërheqies së tyre.

Neni 3

Shpërndaria e vlerave financiare

Shpërndarja e vlerave financiare të shoqërive huamarrëse bëhet sipas koeficientit të kthimit të shumave kreditorëve, i cili është i veçantë për secilën shoqëri huamarrëse.

Neni 4

1. Koeficienti i kthimit të shumave kreditorëve llogaritet si raport i (a + b)/c ku:

"a" -ja nënkupton shumën e mjeteve monetare që shoqëria huamarrëse në administrim ka në llogarinë bankare,

"b" -ja nënkupton shumën që sigurohet nga shitja e aseteve (a) e sekuestrimeve të pasurisë së personave juridikë ose fizikë të lidhur me shoqërinë huamarrëse dhe,

"c" -ja nënkupton shumën e detyrimit të mbetur që shoqëria huamarrëse ka ndaj kreditorëve të saj.

Në kuptimin e shumës në favor të kreditorit do të konsiderohet edhe çdo e ardhur tjetër që realizohet nga veprimtaria e biznesit deri në momentin e shitjes së pasurisë së shoqërisë huamarrëse.

2. Si shumë e detyrimit të mbetur quhet diferenca e vlerës së kapitalit fillestar të depozituar

nga kreditori në një shoqëri huamarrëse, pa përfshirë rikapitalizimin e interesave dhe madhësinë e vlerës së llogaritur e të përfituar prej kreditori në formë interesi.

3. Tërheqja e bërë në formë interesi ose kapitali i zbritet shumës së detyrimit.

Neni 5

Përfitimi nga llogaritja e koeficientit

1. Nga llogaritja e bërë në pikën 1 të nenit 4, përfiton kreditori, depozita e të cilit pas kontrollit të kartelës së depozituar në shoqërinë huamarrëse dhe deklaratës së huadhënies (të verifikuar në qendrën e informatizimit financiar) rezulton me një diferencë dhe konkretisht ndërmjet kapitalit të depozituar dhe shumës së interesit ose të tërheqjes të përftuar.

2. Përjashtohet nga rregulli i parashikuar në pikën 1 të nenit 5, kreditori i cili ka tërhequr interesa të barabarta ose më të mëdha se kapitali i depozituar. Kontrata e huadhënies e lidhur në këto raste ndërmjet kreditorit dhe shoqërisë huamarrëse konsiderohet e përfunduar.

3. Kreditori, subjekt i ligjit nr.7903, date 8.3.1995 "Për deklarinimin e pasurive të të zgjedhurve dhe disa drejtuesve e punonjësve të shërbimit publik", do të përfitojë nga skema e shpërndarjes vetëm pasi të këtë plotësuar kërkesat e ligjit të mësipërm.

Neni 6

Radha e shpërblimit

1. Kreditori i shoqërisë huamarrëse shlyhet sipas shumës së kredisë (depozitës), për efekt kohe sipas kësaj radhe:

- a) Për shumën e depozituar deri 2000 dollarë.
- b) Për shumën e depozituar nga 2001 deri 5 000 dollarë.
- c) Për shumën e depozituar nga 5001 deri 10 000 dollarë.
- ç) Për shumën e depozituar mbi 10 000 dollarë.
- d) Për detyrimet që nuk përfshihen në grupimet e mësipërme.

2. Detyrimet ndaj sigurimeve shoqërore do të bëjnë pjesë në skemën e shpërndarjes.

3. Kthimi do të bëhet në njësinë monetare " Lek" si kurs këmbimi për monedhën e huaj do të jetë kursi i mesatarizuar për vitin 1995 dhe 1996.

4. Shlyerja e kreditorëve të të njëjtit grup renditet sipas madhësisë që ajo ka, dhe kreditorët përfitojnë të njëjtin koeficient shlyerjeje.

5. Detyrimi që shoqëria huamarrëse ka ndaj organit doganor e tatimor, pasi llogaritet, konsiderohet e ngrirë dhe nuk i nënshtrohet shpërndarjes.

6. Përjashtimi i taksës doganore e tatimore bëhet me ligj të veçantë.

Neni 7

Vlefshmëria

1. Si dokument provues për kthimin e shumës së detyrimit të mbetur, të korrigjuar me koeficientin e kthimit të shumës kreditorëve, konsiderohet kontrata e lidhur ndërmjet kreditorit dhe shoqërisë huamarrëse gjer më 23.1.1997.

2. Origjinaliteti i kontratave do të kontrollohet nga administratori dhe eksperti financiar, i cili saktëson dhe vlerën e regjistruar me atë të kartelës së depozituar në shoqërinë huamarrëse. Ankesat e paraqitura për saktësimin e vlerës, si dhe për kontratat e shpërbëra pas datës 32.1.1997, zgjidhen brenda 30 ditëve nga data e njoftimit ose marrjes dijeni.

Neni 8

Shpërndarja

1. Për shpërndarjen e vlerave pasurore secilit kreditor ngarkohet dega në rreth e Bankës së Kursimit dhe ajo e Bankës Kombëtare Tregtare.

2. Shpërndarja e shumave bëhet me para në dorë ose, me pëlqimin e përftuesit, edhe me depozitim në librezë kursimi sipas kritereve bankare, duke zbatuar dhe interesat për periudhën që ato

do të depozitohen në bankë. Llogaritja e interesave bëhet nga data kur secilit kreditor i është përcaktuar shuma që do të tërheqë nga banka, sipas listës së shpallur në shoqërinë huamarrëse.

3. Koeficienti i kthimit të shumës kreditorit dhe koha e fillimit të shpërndarjes së vlerës financiare për secilën shoqëri huamarrëse është i veçantë. Rregulla të hollësishme për zbatimin e koeficientit të kthimit të shumës dhe për kohën e shpërndarjes së tyre caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9 **Publikimi**

1. Lista e kreditorëve bashkë me vlerat e llogaritura të kapitalit për shpërndarje shpallen pranë secilës shoqëri huamarrëse, në degën ose filialin e saj në rreth jo më vonë se data 15 korrik 1998.

2. Personi, i cili nuk gjen emrin e tij në atë listë dhe disponon dokumente autentike që vërtetohet kredinë e tij në atë shoqëri, ka të drejtën e ankimit, por jo më vonë se data 15 gusht 1998. Ankimi i paraqitet Grupit të Administratorëve dhe Ekspertëve të Pavarur. Pas marrjes së përgjigjes nga ky i fundit, kreditorët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit jo më vonë se 10 ditë nga dita e marrjes së përgjigjes.

Neni 10 **E drejta e parablerjes**

Kreditori ka të drejtë të futet si blerës i parë në shitjen e aseteve të shoqërive huamarrëse. Rregulla të hollësishme për këtë do të caktohen me ligj të veçantë.

Neni 11 **Përfjashtime**

Personat juridikë a fizikë që janë të lidhur me shoqërinë huamarrëse, personeli drejtues dhe administrativ i tyre, administratorët dhe ekspertët kontabël, vendas ose të huaj, anëtarët e Grupit të Mbikëqyrjes dhe personeli tjetër administrativ e buxhetor që në mënyrë direkte ose indirekte rezultojnë i lidhur me një shoqëri huamarrëse, përjashtohet nga e drejta e parablerjes e rregulluar në nenin 10 të këtij ligji ose nga çdo shitje tjetër.

Neni 12 **Pendimi**

Personat fizikë ose juridikë, vendas a të huaj, të cilët vullnetarisht japin kontributin e tyre në dorëzimin dhe arkëtimin e vlerave financiare të fshehura, krahas efekteve favorizuese ligjore të parashikuara, përfitojnë dhe një kontribut në shumën prej 5% për çdo shumë të arkëtuar. Organet përkatëse ruajnë karakterin anonim të këtij veprimi.

Neni 13 **Dispozita kalimtare**

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të caktojë rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij ligji

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2139, datë 9.6.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani